




### PROCESVERBAL

Nga mbledhja e rregullt e Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur më **26.12.2024**, me fillim në orën **10:10**. Mbledhjen e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit, **z. Arbër Zenuni**. Në fillim kryesuesi konstatoi kuorumi për mbajtjen e mbledhjes ekziston. Në fillim të mbledhjes, nga 31 anëtarë, të pranishëm kanë qenë 23.

**Kryesuesi:** Përshëndetje për të gjithë! I nderuar Kryetar i Komunës, **z. Smajl Latifi**, Nënkyetar **z. Fatmir Iska**, të nderuar anëtarë të Kuvendit Komunal, drejtorë të drejtorive komunale, zyrtarë komunalë, përfaqësues të KFOR-it, medie, të nderuar qytetarë të Komunës së Rahovecit. Për këtë mbledhje të **dymbëdhjetë** me radhë të vitit 2024, së bashku me kryetarin, kemi vendosur për këtë rend dite:

### REND DITE



1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
  2. Pyetjet, përgjigjet dhe diskutimet e kuvendarëve;
  3. Shqyrtimi i raportit të punës së ekzekutivit (kryetarit) për vitin 2024;
  4. Shqyrtimi dhe miratimi i planit të punës së kuvendit komunal për vitin 2025;
  5. Shqyrtimi dhe miratimi i planit të punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB), për vitin 2025;
  6. Shqyrtimi dhe miratimi i planit të punës së Këshillit të fshatit Hoçë e Madhe për vitin 2025;
  7. Shqyrtimi dhe miratimi i njoftimit për shpërndarje të kontratës të lokalit afarist;
  8. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për dhënien e pëlqimit paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë, të pronës së paluajtshme të komunës, P- 02240-76, ZK- Rahovec;
  9. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim afatgjatë, të pronës së paluajtshme të komunës, P- 02240-76, ZK- Rahovec;
  10. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për dhënien e pëlqimit paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës, P- 00325-0, ZK - Hoçë e Madhe;
  11. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër, të pronës së paluajtshme të komunës, P- 00325-0, ZK – Hoçë e Madhe;
  12. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për lirim nga taksa komunale Post-Telekomin e Kosovës.
- Shtesë:**
13. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik parcela P-71510057-05537-2 në zonën kadastrale Rahovec.

**Kryesuesi:** Të nderuar kuvenarë, me shumicë votash (20), votohet rendi i ditës për mbledhjen e 12-të. Rendi i ditës ka 12 pika dhe I pikë shtesë.

**1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar:**

**Kryesuesi:** A ka dikush ndonjë gjë rreth procesverbalit nga mbledhja e kaluar? Nëse jo, e vendosim në votim. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Konstatoj që me shumicë votash (20), votohet edhe pika e parë e rendit të ditës.

**2. Pyetjet, përgjigjet dhe diskutimet e kuvendarëve:**

**Burim Krasniqi:** Faleminderit kryesues! Përshëndetje ekzekutiv, kolegë asambleistë, monitorues, media, të gjithë prezentë. Meqenëse është seanca e fundit e këtij viti, uroj që viti 2025 të sjellë veç të mira për ju dhe familjet e juaja. E përsëris një pyetje për drejtorin e Gjeodezisë dhe Kadastrës. Drejtor, në seancën e fundit ta kam bërë një pyetje rreth historiatit të familjarëve për çështjen e parcelave te rasti i kërkesave që ta shohin çështjen e trashëgimisë për pronat që kanë të bëjnë me çështjen e privatizimit, për fshatrat: Sopniq, Pataqan i Ulët, Pataqan i Epërm, Noshpallë, Senoc, Ratkoc. Në seancë ke thënë që qytetarët mund të bëjnë kërkesë dhe ke thënë që ti e merr obligim personal për lëshimin e çështjes së trashëgimisë. Deri sot kanë bërë kërkesa: Skender Ademi, Driton Hoti, Galip Sylejmani, Berat Hoti, Fadil Gashi, Elami Morina, Naim Gashi, Lulzim Gashi dhe Hamdi Zeka. Këta thonë që nuk kanë marrë historiata. A do t’ju jepet apo jo? A ka pasur ndonjë zyrtar që ka qenë në pushim? Apo ku mbetet premtimi ose ajo që e the në asamble, që në një farë forme u dakorduar për këtë mundësi.

**Defrim Kafexhiu:** I nderuar kryetar, nënkryetar, kolegë anëtarë të kuvendit komunal, drejtorë të drejtorive, media, përfaqësues të KFOR-it. Unë sot, më me dëshirë do të kisha përgatitur ndonjë diskutim, rreth ndonjë pike të rendit të ditës dhe për ndonjë çështje që preket qytetari i komunës së Rahovecit në jetën e tij të përditshme, sikurse që është çështja e energjisë elektrike dhe ankesat e qytetarëve kundrejt institucioneve përgjegjëse, por edhe institucioneve komunale pse jo. Secili nga ne duhet ta bëjmë maksimumin që këto ankesa të qytetarëve të shkojnë në vend të duhur dhe të krijohet zgjidhje për një element jetik për qytetarët, sidomos në prag të festave të fundvitit. Sot, fatkeqësisht po ndihem shumë i turpëruar të flas për diçka tjetër, kur Komuna e Rahovecit është duke e shkelur demokracinë me dy këmbë. Një qeverisje që ka ardhur në pushtet, që zotohet dhe e proklamon demokracinë në çdo veprim që e merr dhe në çdo projekt që e bën. Dua të diskutoj mbi dy vendimet që kanë dalun nga gjykata themelore në Gjakovë. E thash, si anëtar i kuvendit po ndihem i turpëruar dhe besoj që ndihet njëjtë secili prej 30 anëtarëve të kuvendit, duke e përfshirë edhe kryetarin e komunës që ka ardhur në pushtet me votë prej qytetarëve të kësaj komune. Kryetari e ka marrë shumicën e votave dhe lejon që një drejtor i emëruar prej tij të keqpërdorë detyrën e vet zyrtare. Nëse i marrim incizimet dhe videot e mëhershme të seancave, e shohim që fjalët e kryetarit kundrejt këtyre proceseve gjyqësore të zyrtarëve të lartë publik në Komunën e Rahovecit, kanë qenë tjera. Teksa tani kemi një heshtje totale kundrejt këtyre proceseve, edhe pse proceset kanë marrë fund. Unë më pak dua të flas për drejtorin, sepse drejtori është i emëruar prej kryetarit dhe i jep llogari atij para llogarisë që i jep qytetarëve të komunës së Rahovecit. Dua të flas mbi dënimin e kryesuesit të kuvendit komunal për vjedhje votash. Të flas për demokracinë është element jetik që ne po e gëzojmë sot, dikush ka luftuar për këtë sistem që ne të jetojmë të lirë në këtë formë të funksionimit të institucioneve dhe që jemi në shërbim të qytetarëve. Sot, Komuna e Rahovecit e ka shkelur demokracinë, e ka shkelur ligin dhe nuk po e jep asnjë argument kundrejt këtij procesi. Dua ta pyes kryetarin e komunës, a është kaq e parëndësishme vjedhja e votës që mos ta flasë asnjë fjalë për këtë çështje. Besoj që ky diskutim është i rëndësishëm dhe këto pika të rendit të ditës fatkeqësisht duhet të jenë dytësore. Parësor është diskutimi i dënimit të kryesuesit të kuvendit komunal për vjedhje votash. Kryetari i komunës nuk ka përgjegjësi ndaj kuvendit, por, i jep llogari. Kryetari gjithashtu është edhe kryetar i degës së Aleancës në Rahovec. Grupi i kuvendit të Aleancës e ka zgjedhur kryesues të kuvendit dikë që ka pasur aktakuzë në kohën e zgjedhjes dhe dikë që sot është i dënuar për vjedhje votash. Nëse kalojmë te pika tjetër e rendit të ditës: Raporti i punës së kryetarit për vitin 2024, sikur çdo vit tjetër i kemi edhe zotimet e kryetarit dhe unë dua t’i përmendi disa. Zotimi i parë: Komuna është e hapur për qytetarët, transparencë e plotë dhe llogaridhënie. Ky kryetar nuk i jep llogari kërkujt. Ky kryetar i ka marrë votat dhe tash është në pikëpyetje se si i ka marrë votat, sepse gjykata po thotë ndryshe prej asaj se si e thotë kryetari. Zotimi i dytë: Komunë që qeveriset drejt e mirë, ligjshëm dhe me performancë të lartë. Ligjshëm kjo komunë nuk po

udhëhiqet, sepse e kemi personin e dytë më të rëndësishëm në komunë, i cili prej gjykatës themelore është i dënuar për vjedhje votash. Është i dënuar për një të drejtë që e kanë qytetarët dhe është një prej elementeve kryesore të funksionimit të këtij sistemi që është bërë me mund. Zotimi tjetër: Standarte të larta të qeverisjes. Kjo qeverisje i ka standartet më të ulëta se çdo qeverisje komunale në nivel vendi, duke mos i përfshirë specifikisht edhe disa komuna që nuk kam qejf hiç t'i përmendi. Këtu nuk ka standarte të larta. E kemi një drejtor të dënuar për keqpërdorim të detyrës zyrtare, që është derivat i vjedhjes së votës që ka ndodhur dikur. Kemi edhe raste të tjera që do të marrin epilog shumë shpejt dhe si kryetari të mos e thotë asnjë fjalë.

**Kryesuesi:** I nderuar, 5 minuta u bënë. A ke pyetje apo përgjigje? Mos dil te plani punës së kryetarit dhe mos u merr me institucione të tjera. Mos e merrë minutazhin e të tjerëve, sepse është mbledhja e fundit. Me mirëkuptim, vazhdo dhe përfundoje.

**Defrim Kafexhiu:** Secili anëtar i kuvendit e ka të drejtën e fjalës dhe e ka kohën e vet, të garantuar me rregullore dhe me ligj. Dua ta kërkoj një akt moral, prej kryetarit të komunës dhe prej kryesuesit të kuvendit. Më vjen keq që, ende është vullneti që t'ia ndalim fjalën dikujt që po flet diçka shumë të rëndësishme, përderisa i njëjti është i dënuar për vjedhje votash. Nëse juve kjo nuk ju duket asgjë, atëherë më vjen keq që jeni krejt të tillë. Kryetari nëse nuk merr veprim, që dikush me vetëdije ka kontribuar në devijimin e vullnetit të qytetarëve, atëherë kjo është fatkeqësi për popullin tonë dhe fatkeqësi për institucionin e komunës. Zotimi tjetër i kryetarit thotë: Komunë, ku përkushtimi për të vepruar ndershëm dhe në pajtim me ligjin, veçse vullnet, përcaktimi i të zgjedhurve jetësohet edhe si detyrim moral ndaj zgjedhëzve dhe ndaj ligjit. Për cilin ligj e ke fjalën kryetar? Nëse do të kishte ligj, sot do të kishim dorëheqje, jo ndalje të fjalës të anëtarët të kuvendit. Kërkoj që, minimalisht duhet të ndodh një akt moral, qoftë prej drejtorit, qoftë prej kryesuesit të kuvendit komunal. Duhet të japin dorëheqje që të dalin faqebardhë ata, komuna jonë dhe ne si kuvend. Po e them edhe një herë, secili prej neve ndihet i turpëruar që një prijës i një institucionu të jetë i dënuar për diçka që varemë prej saj dhe për diçka që ne kemi ardhë këtu.

**Kryesuesi:** I nderuar kryesues i kuvendit të komunës, Arbër Zenuni, drejtorë të drejtorive, nënkryetar i komunës, anëtarë të kuvendit, përfaqësues të LMT-së, media. Prej sot e kemi një kontratë të re me përcjelljen e punimeve të kuvendit, sipas ligjin e kanë fituar të drejtën. Fillimisht ju uroj shëndet dhe urime për festat e fundvitit. Urime dhe gëzuar për shumë mot për ata që i festojnë Krishtlindjet. Rendi i ditës është përcaktuar dhe është votuar. Përgjigjen Burimit do t'ia jep Afrimi Oruqi. Besoj që komuna jonë ka mundësi të nxjerrë historiate, ndoshta ka mundësi që edhe zyrtarët të jenë në pushim vjetor. Ne po flasim në një situatë, e cila është e kuptueshme, sepse me 9 shkurt janë zgjedhjet. Është e drejtë e secilit ta ketë mendimin dhe pikëpamjet e vet, sa i përket aspekteve që lidhen me ligjin. Këtu u përmeden disa prej çështjeve që janë në pikën e tretë ose të katërtën, te raporti i kryetarit të komunës e që lidhet me zotimet e kryetarit të komunës. Kualifikimin, vlerësimin dhe rezultatet, se a është një komunë transparente, demokratike dhe a ndërmerre veprime të ligjshme apo jo, e bëjnë profesionalisht institucionet kompetente dhe organizatat mbikëqyrëse. Ne transparencë, është shumë e vërtetë që komuna jonë është e mirë. Është e mirë në performancë, në qeverisje të hapur dhe në qeverisje demokratike dhe në renditje është shumë lart. U përmend akti moral, morali publik dhe morali në politikë. Të them të drejtën, së pari me aq sa unë jam në dijeni, aktvendimi i gjykatës themelore për të dytë e lartëcekurit ende nuk ka ardhur. Gjykata themelore mbase ka vendosë, por, palëve ende nuk iu ka ardhur asgjë. Ne nuk i komentojmë vendimet e gjykatës dhe besoj që jemi të vetëdijshëm dhe të ndërgjegjshëm që nuk duhet të komentohen vendimet e gjykatës, sepse ka forma, mënyra e rrugë për t'i trajtuar, nëse ke pajtueshmëri apo jo. Ligji e ka paraparë që në moment kur ka një aktgjykim të shkallës së pari, e ke edhe të drejtën e ankesës dhe vendimet e shkallës së parë nuk janë vendime përfundimtare. Te akti moral, te kryesuesi nuk dua as ta komentoj, sepse është pikëpamje e tij se si e vlerëson ai moralin publik. Megjithatë, kryesuesi i kuvendit është zgjedhë me votë nga ky organ dhe në çdo situatë, kushdo që e bën shumicën në kuvend, mund ta zgjedhë një kryesues të ri. Nuk nuk i jap vetes të drejtë, për shkak se disa kanë qejf të flasin shumë për moralin dhe une t'ia përmbush ambiciet dikujt, e që unë t'i kërkoj dikujt dorëheqje e në fakt nuk është e drejtë e imja. Mandati është i kuvendit, nëse mendon t'i jap zgjidhje, atëherë i imbetet kuvendit dhe nuk mund t'i tregoj unë si kryetar kryesuesit se çka të bëjë ai. Unë përfaqësoj konceptin që nuk bëj ndërhyrje në pushtete të tjera. Dikush tjetër ndoshta përfaqëson konceptin e cënimit të cilitdo institucion. Pra, janë dy shkolla politike. Unë nuk i takoj shkollës

që t'i tregoj gjykatës ose prokurorisë, madje edhe ta akuzojë për diçka. Pra, ju paralajmëroj, unë e kom fituar mandatin në 2017, 2021, 2010 dhe asnjëherë nuk është kualifikuar nga askush, nga asnjë institucion, që mandati i kryetarit është fituar me vota të keqpërdorura. Janë organet e specializuara që ata e japin verdiktin, nuk e jep një anëtar i kuvendit, përkundër asaj që ai ka të drejtë të mendojë. Te akti moral, sa herë ndodhin situatat të ndryshme, mbi 500 herë edhe unë është dashur të jap dorëheqje, jo për shkak se kërkon një anëtar i kuvendit, por, për shkak se në aspekti moral lidhet edhe me atë që javën e fundit nuk kemi rrymë hiç! Unë nuk jam kompetent, por moralisht nëse do të isha japonez, është dashur të jap dorëheqje. Mos të flasim për atë që menjëherë është dashur fillimisht të japin dorëheqje, Albin Kurti dhe Artanë Rizvanolli. Nëse flasim për moral në politikë, kjo duhet të ndodh, sepse të njëjtit njerëz kanë thënë para 2-3 jave që i kemi marrë të gjitha masat dhe veprimet, që mos të kemi probleme me energji elektrike. Më pyet mua se si ia bëj deri në gjysëm të natës, duke përdorur edhe gjuhë joadekuate me ata që kanë përgjegjësi. Moralisht pse nuk japin dorëheqje? Jo, sepse ata janë të bindur që janë duke e bërë punën e vet, ashtu siç është i bindur edhe Arbri dhe Avniu që janë duke e bërë punën e tyre. Pa keqkuptime, fjalimi i të nderuarit Defrim Kafexhiu, ishte i atij karakteri dhe në thelb e kishte atë mesazh sikurse kërthiza (nyja) e të gjitha zhvillimeve ballkanike është Rahoveci, si dhe aktin moral që lidhet me ndërjegjen shtetërore po e lyp në Rahovec. Parimisht ke të drejtë, por jo pa dhënë dorëheqje kryeministri dhe ministrja e energjisë Artanë Rizvanolli, sepse është një gjendje mjaft e përkeqësuar e energjisë elektrike. Kryeministri nuk i përgjigjet kryeprokurit të shtetit. Moralisht ata duhet të japin dorëheqje, ligjërisht nuk kanë ndonjë aktgjykim, ashtu si nuk e kemi as për këta dy. Prandaj, të jemi pak më serioz dhe më objektiv. Edhe kjo deklaratë ndoshta mund të tingëllojë si një lloj fushate, ashtu siç e pate edhe ti, ekskluzivisht për fushatë që është shumë normale. Mos e harro faktin që ende nuk ka ardhur aktgjykimi i shkallës së parë, më pas duhet të presim se çka po thotë shkalla e dytë. Ju lutem, ta presim vendimin përfundimtar të formës së prerë dhe nëse vjen vendimi i formës së prerë, mbaje në mend mirë Defrim Kafexhiu, nuk ka nevojë t'i them kërkujt dhe në qoftëse jam kryetar komune dhe në qoftëse nuk jam dhe drejtori i arsimit është drejtor i arsimit edhe atëherë kam të drejtë t'i kërkoj për dorëheqje. Nëse unë jam kryetar, shablloni është gati dhe lirohet nga detyra. Sa i përket korrupsionit, për korrupsion dhe për moral publik nuk ia jap dorën as Albin Kurtit as kërkujt dhe nuk është mirë të ngutemi, sepse kur flasim për ligjin duhet t'i presim letrat – vendimin dhe ju lus që t'i respektojmë procedurat. Nëse ka bazë për ankes, përsëri duhet ta presim vendimin e formës së prerë dhe atëherë e shih kush është Smajl Latifi. Nuk është mirë që t'ia merr inatin komunës tënde, për shkak të etheve të fushatës, sepse edhe ata që ti iu ke besuar që aktualisht janë në pushtet që 4 vjet, edhe ata flasin dhe shkruajnë mirë për komunën tonë. Grantet që fitohen, fitohen nga Qeveria e Kosovës, e cila është aktere dhe merrë pjesë në vlerësime. Kualifikimet që Komuna e Rahovecit a qeveriset mirë, me performacë, ligjshëm dhe transparencë, vlerësohet nga pushteti gjyqësor dhe nga organet politike të pushtetit qëndror. Mos e prish shijen e festës dhe t'u kisha lutur që për këtë vit të ri, mos ia merr inatin komunës tonë. T'i shohim aktgjykimet dhe të shohim për hapat tutje. Burim, i kam takuar edhe unë ata të fshatit Pataqan dhe më pyetën se si mund të bartet trashëgimia dhe a ka lehtësira. Për këtë temë flet drejtori Afrim Oruqi.

**Kryesuesi:** Përshëndetje për të gjithë! I nderuar kryetar i komunës z. Smajl Latifi, nënkryetari Fatmir Iska, drejtorë të drejtorive komunale. Dua t'i them dy fjalë për hir të qytetarëve të komunës së Rahovecit.

**Kryetari:** Kryesues, a ma jep të drejtën mua të flas?!... Më fal që po të ndërprej... Është kërkesë e imja dhe nuk ka personale asgjë, të lutem ulu në vend dhe mund të flasësh nga vendi. Nuk është mirë të biesh në lajthitje pse flet Defrimi. Defrimi e ka pikëpamjen e vet dhe nuk është mirë të kanalizojmë diçka tjetër. Nuk dua t'i jap peshë kësaj teme, sepse ne jemi në pritje dhe nuk besoj që qytetarët i meritojnë t'i shohin këto kualifikime, sidomos për këtë temë.

**Sinan Kryeziu:** Faleminderit kryesues! Përshëndetje për të gjithë të pranishmit në sallë. Këtu u fol për ligjin dhe të drejtën. U citua disa herë fjala, "vjedhje votash". Këta është mirë ta lexojnë ligjin dhe ta mësojnë perceptimin e fjalës "vjedhje". Po të ishte dënuar kryesuesi nga ana e gjykatës për vjedhje, tani do të ishte në vuajtje të dënimit. Singërisht, është shumë keq ta përdorim foltoren dhe të shesim moral, kur flasim për një koleg në kuvendin komunal. E kam lexuar me vëmendje aktin akuzues, në të cilin thotë që është bërë një lëshim gjatë numërimit të votave në atë sallë, kryesuesi ka qenë komisioner i partisë përkatëse. Aty thotë decidivisht që nuk janë përputhur votat e partisë së NISMA-së. Ligji e thotë që në vepra penale është i rëndësishëm qëllimi dhe pasoja. Nëse do të ishte dyshimi i bazuar mirë që, kryesuesi në atë periudhë kohore, nëse do të kishte qëllim që t'i kryente favor Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, ky do të vidhte

vota për Aleancën. Aty thjesht është gabim teknik. Akti akuzues thotë: Në bashkëkryerje është kryer vepra penale. A me dashje apo pa dashje? Gjykata e ka konsideruar që është pa dashje dhe është dënim alternativ. Është keq që po bëni lojë fjalësh për qytetarin dhe unë e kuptoj që shumica kanë problem ta kuptojnë ligjin dhe mendojnë që ky është kriminel. Gjykata kriminelet i qon në vuajtje të dënimit me burg. Kur kam qenë në vetëvendosje thoja që do ta bëjmë burgun 12 kat, për t'i dërguar kriminelët në burg. Kryesuesin e keni përballë, në ballë të oxhakut. Këtu, pa marrë parasysh partinë politike, nuk e shfrytëzoj rastin ta lëndoje askënd, sepse e shohin edhe familjarët përmes kamerave.

**Kryesuesi:** Faleminderit Sinan! Për hir të qytetarëve të komunës së Rahovecit, desha të bëj një koment. Unë e respektoj vendimin e çdo gjykata. Ata që mundohen të bëjnë mjegull dhe të ma njollosin emrin, do të ballafaqohen tutje.

**Defrim Kafexhiu:** Atëherë, faleminderit! Ta qartësoj pak fjalën e kryetarit. Asnjërin nga Aleancës prej komunës së Rahovecit, nuk e ndërroj me komplet ata të nivelit qëndror. Unë nuk ia bëj argatin kërkujt dhe nuk jam duke u munduar ta dënoj dikë për çështje elektorale, ashtu siç e tha kryetari. Sinqerisht më vjen keq, kam pasur dhe vazhdoj të kem ende respekt për Arbër Zenunin, por, është keq si Komunë e Rahovecit situata në të cilën ndodhemi. Sinani e tha që kriminelat e kanë vendin në burg dhe nuk është krim që dikush e ka një aktakuzë ose dënim prej gjykatës themelore, e përmendi që nuk është vjedhje dhe që unë po bëj lojë të fjalëve këtu. Unë nuk po bëj lojë të fjalëve, seancat e gjykimit edhe për drejtorin edhe për kryesuesin kanë qenë publike, me media dhe monitorues të rrjedhjes së procesit gjyqësor. Unë thellësisht po ndihem keq, se Sinani tha dikush prej familjarëve mund të preket, gjithashtu edhe unë jam prekur dikur, sepse në politikë secili do të prekemi. Ne do t'i vuajmë pasojt e veprimeve tona, qoftë kryetari, kryesuesi, një drejtor apo edhe një anëtar i kuvendit. Në formë të qëllimshme apo të paqëllimshme, është devijimi i vullnetit të qytetarëve dhe sipas ligjit quhet vjedhje votash. Prapë po e them, unë kam respekt për Arbër Zenunin, për karakterin e tij dhe si kryesues dhe më vjen keq që ai po përballlet me këto situata të tilla, por, më i turpëruar po ndihem kur në situata të tilla nuk kemi veprime që përkojnë me moralin politik, që e përmendi kryetari.

**Afrim Oruqi:** Faleminderit kryesues! Në pyetjen e kuvendarit Burim Krasniqi, përkundër një kornize ligjore që qytetarëve iu pamundëson të kërkojnë informacion pa autorizim për të gjitha pronat, ne jemi zotuar këtu që varësisht prej zonës, secili qytetar që do të bëjë kërkesë do të pajiset me historiat të parcelës. Janë bërë diku 17 kërkesa, një kërkesë për historiat i merrë 3-7 ditë. Ne kemi filluar dhe i ftoj të gjithë ata që mënojnë që u kanë bërë të padrejtë nga proceset e fundit të privatizimit. Historiatin do ta marrin me shkrim dhe pa pagesë. Kërkoj mirëkuptimin e tyre që historiatet mund të vonohen pak, sepse janë mbi 70 vite për një parcelë.

**Burim Krasniqi:** Drejtor, kërkesat janë në proces? Janë duke u përpunuar dhe shumë shpejt pritet t'i marrin përgjigjet?!

**Afrim Oruqi:** Po, secili qytetar që e ka bërë kërkesën. Përkundër kapaciteteve të vogla, sepse ne e kemi një gjeodet që e kryen këtë punë.

**Sejfullah Sejfullahu:** Përshëndetje për të gjithë! Kryetar, nënkryetar, kolegë asambleistë, drejtorë, vëzhgues! Për fundvit ka dashur të flas shumë, por, nuk po them asgjë. Në momentin që nuk them asgjë, kam shumë për të folur. Sinqerisht, prej qeverisjes lokale dhe prej asaj qëndrore, fshati im është anashkaluar, mos të them është diskriminuar. Gjithësesi, unë e kuptoj kufizimin e buxhetit dhe ju e dini që ka më shumë se 2 vite që nuk është bërë asgjë në infrastrukturë. Viti 2024 nuk ka qenë vit i mirë. Realisht në vitin 2023 janë bërë disa investime të qëlluara në Krushë. Bazuar në projekt-buxhetin e vitit 2025, e kam parë edhe aty që nuk ka diçka të veçantë për Krushën. Mos të harrojmë, në Krushë të Madhe janë 4 muze dhe kemi kryetarë, kryeministra, ambasadorë, turistë dhe vizitorë të mjaftueshëm. Shpresoj që ekzekutivi të gjejë forma për investime dhe ta rritni volumin e punëve në Krushë të Madhe.

**Fahrije Lushi:** I nderuar kryesues, kolegë këshilltarë dhe të gjithë të pranishëm. Pasi jemi në festat e fundvitit, uroj që 2025-ta të jetë një vit pak më ndryshe për të gjithë qytetarët dhe për juve këtu që jeni. Shqetësimi im ka të bëjë me një projekt që ka qenë i planifikuar dy vite radhazi dhe nuk është realizuar. I drejtohem drejtorit të bujqësisë, ose secilit që mund të jep kontribut. Ka të bëjë me kanalën e kullimit të tokave në fshatin Malësi e Vogël. Ky projekt që dy vite është menduar të kryehet. Fermerët kanë lënë hapësirë nga tokat e tyre dhe punimet nuk kanë vazhduar. Është bërë gati terreni për punë, pra, janë dërguar materialet aty dhe nuk është vazhduar. Më pas, materialet që kanë qenë të adresuar për këtë kanal kullimi, janë marrë dhe janë dërguar në një pjesë tjetër brenda fshatit. Kërkoj shpjegim nga ana e drejtorëve

përkatës dhe a ka mundësi të dimë se kur do të realizohet ky projekt, sepse toka është punuese dhe qytetarët kërkojnë llogari.

**Nënkryetari:** Faleminderit i nderuar kryesues! Të nderuar anëtarë të kuvendit, drejtorë, të gjithë ju të pranishëm. Do të jem i shkurtër në përgjigje për pyetjen e Sejfullah Sejfullahut. Prej këtij pushteti lokal, nëse është investuar diku më shumë se sa në Krushë të Madhe, atëherë unë nuk e di çka duhet të thonë të tjerët, sa i përket investimeve kapitale.

**Sejfullah Sejfullahu:** Nënkryetar, nuk është njëjtë sikur një vendbanim që i ka 241 të vrarë dhe 4 muze dhe e ka infrastrukturë të dobët, sikur një vendbanim tjetër që i ka vetëm 30 shtëpi. Mendoj që nuk duhet të tërheqim paralele të tilla, por, po flas në bazë të kërkesave të qytetarëve. Kam qenë gjithmonë falënderues për çdo përrurim që është bërë dhe sinqerisht mendoj që është dashur të bëhet më tepër në Krushë.

**Nënkryetari:** Kur e bëre pyetje, e përmende që është “anashkaluar nga pushteti lokal dhe prej qeverisë”. Unë flas gjithnjë sa i përket pushtetit lokal. S’ka nevojë t’i diskutojmë se sa janë të vrarë e sa kemi vuajtur komuna jonë, ne duhet t’i japim ligjerata dikujt tjetër, e jo këtu mes vete. Edhe një herë: Nëse ka vendbanim, mbi bazën e mundësive buxhetore, që është investuar më shumë se sa në Krushë të Madhe, ma gjej diku dhe më bind me fakte. Ndërsa unë t’i listoj të gjitha.

**Albnor Mullabazi:** Faleminderit kryesues! I nderuar nënkryetar, kolegë drejtorë, asambleistë. Sa i përket pyetje së zonzjës Fahrije Lushi në lidhje me kanalën e kullimit në Malësi të Vogël: E kemi kontratën e nënshkruar për rregullimin e kanaleve dhe Malësia është e përfshirë me tre akse. Me kërkesë të banorëve të fshatit jemi tërhequr nga tokat bujqësore dhe kemi shkuar brenda fshatit. Aty është kryer një punë e madhe dhe do të vazhdojmë në pjesën brenda tokave punuese.

**Bejtullah Deliu:** Faleminderit i nderuar kryesues, zëvendëskryetar, drejtorë, asambleistë, media, të pranishëm në sallë. Dua të dal pak nga këto rrjedha, edhe pse drejtori i kulturës nuk qenka aty. Për disa vite me radhë ndodh që nuk ka iniciativë për një organizim të mirë të fundvitit. Gjatë kohës verore i kemi pritur bashkatdhetarët dhe i kemi pasur shumë momente të mira që i kemi kaluar. Fundviti e ka një farë lezeti të vet, nëse dekorohet qyteti. E shoh që shoqata Enologjia me drejtorinë e Ekonomisë e kanë bërë një hap për panair të verës. Çka ka ndërmarrë DKRS në këtë aspekt? Duke marrë parasysh që datat dihen dhe nuk mund të jeni të papërgatitur. Në komunën tonë, me vite me radhë ndodh që ditëve të fundit merren 5-6 persona dhe provojnë të rregullojnë diçka, e në fakt nuk ka as kohë as vullnet të mirë. Drejtor, pse po ndodh kjo? A është neglizhencë, apo nuk e shihni të arsyeshme të investoni në këtë aspekt?

**Leonard Morina:** Përshëndetje për kryesuesin, nënkryetarin, drejtorët, kolegët asambleistë, të pranishëm tjerë. E kam një pyetje për Drejtorinë e Arsimit: Si qëndron situata me kontratë të higjienës në shkollë? A kanë shkollat kontratë të tillë dhe a kanë shkollat ndonjë kontratë tjetër që ka të bëjë me mirëmbajtje dhe që nuk është nënshkruar për shkak të mungesës së buxhetit?

**Sejfullah Sejfullahu:** Insistoj te nënkryetari edhe pse nuk dua të debatoj. I përmende investimet kapitale. Në bazë të kërkesave dhe nevojave, nuk diskutohet që investime kapitale keni bërë gjithkund më shumë se në Krushë. Sa i përket investimeve të qeverisë, ne nuk kemi mekanizëm tjetër për adresim, përsëri duhet të flasim këtu. Është hequr palestra sportive, stadiumi, rruga, rrethi etj... Presioni duhet të bëhet këtu, sepse atje si PDK nuk më lënë as në oborr.

**Nënkryetari:** Mos të kemi keqkuptime! Unë nuk kam autorizim të flas për autoritetet qendrore. Kush është i interesuar, sot n’ora 12:00 do të jetë i pranishëm ministri i Shëndetësisë, nëse keni diçka rreth ministrisë që e udhëheqë. Si pushtet lokal jemi për secilin qytetar, gjithmonë flasim mbi bazën e mundësive buxhetore.

**Afrim Dina:** Faleminderit kryesues! I nderuar nënkryetar, kolegë drejtorë, anëtarë të kuvendit. Faleminderit z. Deliu. Këtë vit i kemi hapur me kohë procedurat për zbulimin e qytetit. Aty kanë aplikuar 3 kompani, njëra prej atyre ka bërë ankes, një herë brenda në komunë dhe më pas në OSHP dhe me këtë rast nuk kemi pasur të drejtë të operojmë me kompaninë fituese. Prej datës 20 jemi organizuar me disa donatorë ta zbulojmë rrugën “Xhevat Kasapi”. Kemi pak problem edhe me hapësirë, sepse ndërkohë duhet që edhe rruga të bllokohet. Aktiviteti “Panairi i verës” fillon më datë 27. Me rregullimin e sheshit qendror, të gjitha këto çështje do të jenë më të lehta.

**Defrim Kafexhiu:** Atëherë, po bashkëngjitem me kritikën me kritikën e kolegut Bejtullah Deliu. Besoj që duhet të krijohet një standart tjetër i aktivitetëve dhe realisht duhet të fillojnë më herët që edhe të ketë funksionim ashtu siç duhet dhe qytetarët ta ndjejnë më afër organizimin që e bën Komuna e Rahovecit, përkatësisht Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport. Dështimi besoj që është mungesë e informimit dhe mungesa e një parapërgatitje më herët, të paktën një muaj.

Komuna e Rahovecit tentimin për të organizuar diçka, duhet ta llogarisë si investim, sepse çdo komunë ndan mjete për organizimin dhe vendosjen e atyre shtëpizave. Nuk besoj që arsyeja ka qenë moti i keq, sepse vitin e kaluar përkundër motit të keq, organizimi në bashkëpunim me Hardhfestin ka qenë brilliant. E kam edhe një kërkesë tjetër për Drejtorinë e Shërbimeve Publike. Te rruga “Gëzim Hamza” aty te kthesa e parë, para se të shkojmë te “kthesa e pazarit” mbi fabrikë, të vendosen policë të vdekur në dy vende, shkak i kthesës dhe i mungesës së trotuarëve. Fëmijët që shkojnë në shkollën “Bekim Sylka” e kanë rrezik atë rrugë për shkak të qarkullimit të shpejt të automjeteve. Besoj që në dy kthesa aty ka nevojë për policë të vdekur.

**Burim Krasniqi:** Kryetar, po ju drejtohem juve edhe pse nuk është kompetencë e juaja! Besoj që keni pasur shumë thirrje këto ditë, për shkak të gjendjes me rrymë. A ka informacione pse është kjo situatë, sepse me të vërtetë është e papërballueshme. Nuk është shumë problem për neve që jetojmë në Kosovë, sepse kemi filluar të mësohemi, por këtë gjendje nuk e mbaj në mend, shumë moti nuk ka qenë e tillë. Mërgimtarët që i kemi dhe vinë, por fëmijët e tyre irritohen. A jemi të interesuar që ata të vinë, apo ta krijojmë një vend kur “nesër” ata të përtojnë ta vizitojnë Kosovën. Kërkoj mirëkuptimin, që ta përdorësh autoritetin tënd në kuptimin pozitiv si kryetar komune dhe në qoftëse është nevoja, si LDK jemi të gatshëm t’ju mbështesim kudo që e vlerësoni, pse jo edhe me një protestë.

**Kryetari:** T’ju them të drejtën, tema më e rëndësishme është kjo. Si kuvend komunal nuk kemi kompetencë të shpallin gjendje emergjente energjetike, sepse nuk varet asgjë nga ne, por, në rast se unë do të isha Qeveria e Kosovës, atëherë do ta kisha thirrur një seancë të jashtëzakonshme të parlamentit dhe do ta shpallje gjendje të jashtëzakonshme. Mbrëmë janë takuar në një mbledhje urgjente, ministria e energjisë, KOST-i, KEDS-i, ZRE-ja etj... dhe të shkojë kaq keq situata dhe mos të merret asnjë masë, ndërkohë që fatura me çmime të larta. Unë kam biseduar me drejtorin e operacioneve strategjike në KEDS dhe ata nuk kanë shumë shpjegime dhe kanë arsyttime për mbingarkesë të sistemit. Kam biseduar me këta të Gjakovës, sepse ne jemi në rajonin e distriktit të Gjakovës. Dikush është kujdesur të komentojë edhe që kinse mos t’i vlerësoj punëtorët e KEDS-it. I vlerësoj pafund, sepse deri në 3 të mëngjesit kanë punuar nëpër terren, duke e rrezikuar veten edhe për fatalitet. Në fund, menaxhmenti i lartë i KEDS-it nuk ka dhënë shpjegim zyrtar se pse janë duke ndodhur këto avari. Qeveria e Kosovës gjithashtu ende nuk ka dalur me një shpjegim, përveç asaj që, kurseni rrymën kondicionerët lëshoni pas orës 24 dhe nxehuni me pelet dhe dru.

**Burim Krasniqi:** Te ne në lagje, një fazë nuk punon asnjëherë. Këtu është lënë qëllimisht, që mos të përdoret sistemi i vjetër i nxemjes qëndrore. Në këtë rast, kursimi ndodh vetëvetiu.

**Kryetari:** Shumë njerëz më kanë shkuar dhe të gjithëve iu kam përgjigjur. Ne e kemi një paradoks, klimat subvencionohet dhe ato nuk mund të përdoren. Kjo ndodh veç në Republikën e paçmuar të Kosovës dhe ndodh nga Qeveria e Kosovës. Ende nuk ka shpjegim zyrtar nga ministria e Ministrisë së Ekonomisë. Nuk dua të futem në kualifikime, se sa po blehet energjia nga importi dhe me çfarë çmimi. Unë kam dalur me një reagim, me mundësitë e mia dhe kam thënë që gjendja me energji elektrike në komunën e Rahovecit është shumë keq. Qeverie e Republikës së Kosovës, mbrëmë ka dalur dhe bënë thirrje veç për kursim. Dje e kam pasur një kërkesë specifike, bizneset kanë filluar të dëmtohen. Një servis nga Xërxa më tha që të gjitha makinat iu kanë bllokuar dhe do të organizohemi dhe do ta bllokojmë magjistralen. Iu thash që nëse e bëni këtë, frikohem sepse atëherë mund të ndërhyjë edhe njësi speciale. Pas orës 11 të natës e kam dërguar një ekip në atë terren. Kjo gjendje emergjente ka ndikuar që të dëshpërohen qytetarët që jetojnë këtu dhe mos të flasim për qytetarët që jetojnë në mërgatë, të cilët janë tepër të pakënaqur. Shpresojmë që këto dy ditë të krijohet një stabilitet energjetik, sepse ende ka probleme me bojlera dhe filtera në KEK. Realisht, e pashë një postim të një deputeteje para disa viteve, që tani është e fuqishme në kuvend të Kosovës, kishte thënë që: Nuk ka intereson a ka nxemje qëndrore me rrymë, a ka kështu e ashtu. E njëjta deputete sot heshtë, e ka futur “krytë në sallë si struci”. Pavarësisht se kush është në pushtet, qeveria e Republikës së Kosovës është edhe e jona. Sinqerisht, është dashur të dalë me një sqarim zyrtar, t’i kërkojë falje qytetarëve, t’u thotë që nuk ka prodhim të energjisë, apo të thotë që ka mbingarkesë për shkak që rrejtë është i vjetër. Brenda një nate janë djegur, trafoja në Optrushë, në Ratkoc dy herë, trafoja në Xërxë dhe Fortesë. Gjithashtu është e vërtetë që punëtorët e KEDS-it kanë reaguar menjëherë, mirëpo, ka vende që kanë qëndruar edhe tre ditë pa rrymë, si p.sh. një lagje në Krushë të Madhe, kështu ka ndodhur edhe me lagjen Kryeziu në Xërxë, në Celinë etj etj... Unë personalisht kam reaguar dhe kam dhënë intervista. Shpresojmë që të stabilizohet kjo gjendje, sepse probleme

me energji elektrike kanë gjysma e komunave të Republikës së Kosovës. Pra, avaritë që janë krijuar nuk janë që punëtorët e KEDS-it nuk kanë punuar, por janë politikat e gabuara që po i përjetojmë dhe akuza për qeverinë është për trajtimin joserioz për këtë çështje mjaft të rëndësishme.

**Sejfullah Sejfullahu:** E kuptojmë mbingarkesë! Mos ta përmendim Martinin hiç, por të paktën ministrja e Ekonomisë dhe Financave mund ta lëshojë një apel, që të paktën t'u thotë bijave që mos të vinë në atë kohë.

**Ilir Pallqa:** I dënuar kryesues! I nderuar kryetar, nënkryetar, kolegë asambleistë, drejtorë të drejtorive. I dënuar, Avni Morina.

**Kryesuesi:** Fillimisht, kujdes fjalorin! Këtu ka rregulla, jemi institucion.

**Ilir Pallqa:** Nuk është fjalor, është konstatim, si i nderuar – si i dënuar, në rregull është. Kur shkelet rregulla, duhet t'i referoheni diçkaje.

**Kryesuesi:** Respektoje rregulloren, ose nuk ta jap fjalën!

**Ilir Pallqa:** Ti duhet t'ia japësh fjalën, kush të pyet?... Në radhë të parë, ia uroj martesën Lirigzonit, kolegut tonë. E shfrytëzoi rastin t'ia uroj martesën edhe një punonjësi të administratës, Egzon Thaqit. Meqenëse jemi te administrata, po e tregoj një kuriozitet. Shumica e burrave që punojnë në administratë, i kanë gratë të punësuar në sektor publik. Në anën tjetër, një grua në komunë, ndonëse është beqare, i ka dy pozita. Dafina Gashi - kolegja jonë, është këshilltare në kuvend komunal dhe së fundmi e ka një kontratë për konsulencë, me çmim 10.000€, nëse nuk jam gabim. Kjo gjë më duket një konflikt i pastër interesi. Konsulenca edhe këshilltari, ndonëse nuk janë të njëjta, janë të ngjashme. Ajo, pozitën për këshillim dhe konsultim e ka këtu, qoftë për meremetime apo për çështje kulturore. Më duket shumë e paarsyeshme që dikush të punojë, në legjislativ dhe në ekzekutiv si këshilltare. Nuk e di nëse dikush e ka ndonjë shpjegim ligjor, por më duket absurde.

**Kryetari:** Konsulenca është me procedurë të prokurimit, ashtu siç e parasheh ligji. Paraprakisht kemi kërkuar interpretim nga Agjencioni Anti-korrupsion dhe përgjigja është pozitive. Mendova që potencialisht po ia uroj fejesën edhe Dafinës. Mendoj që tema kryesore është dashur të jetë energjia elektrike. Ndoshta si kuvend ta rrisim edhe pak presionin, që të ndikojmë direkt në stabilizim të gjendjes. Në ora 12 do të shkoj ta pres ministrin e Shëndetësisë të hemodializa në QKMF. Është e rëndësishme të thuhet dhe i falënderoj të gjithë prej Florije Boshnjakut, Munib Durgutit, Idriz Vehapi, Samir Mustafa, Smajl Latifi, Sarandë Sallteku, Ministrisë së Shëndetësisë, Entit Kombëtar për Transfusionin e Gjakut. Tani veçse kanë filluar të trajtohen pacientët e parë dhe janë të kënaqur, sepse nuk besoj që diku mund të ketë kushte më të mira se sa në hemodializën tonë. Ky është lajmi më i mirë i këtij viti. Urime edhe një herë për hemodializën dhe këtu nuk kemi dallime, dikush më shumë e dikush më pak, të gjithë janë angazhuar.

### **3. Shqyrtimi i raportit të punës së ekzekutivit (kryetarit) për vitin 2024:**

**Kryetari:** Sipas ligjit, procedurave dhe kërkesave të transparencës, ky raport është publik dhe ka qasje për secilin qytetar shqiptar, të pakicave e gjithashtu edhe japonezët, në faqen zyrtare të komunës. Raporti i ka 25 faqe. E ka fjalën hyrëse dhe pjesën e zotimeve, të cilën nuk e ndërroj, sepse zotimet janë zotime për 4 vjet. Pjesën e prioriteteve që janë për një vit përkatës, ato ndërrohen. Pjesën e synimeve gjithashtu e ndërroj, sepse disa ndërrohen e disa janë në proces. Është raporti i secilës njësi që lidhet me zyrën e kryetarit. Raporti i zyrës ligjore, zyra për informim, raporti i lektorimit, njësia e auditimit të brandshëm, zyra e prokurimit, zyra për barazi gjinore dhe raportet thelbësore të secilës drejtori. Ka plot punë të kryera, sfida dhe arritje. Sfida më e madhe është buxheti i pamjaftueshëm. Planin e të hyrave e kemi kaluar, i kemi kaluar gati 2 milion dhe e kemi shpenzuar buxhetin 98.83 e kemi pasur dje. Besojmë që në fund do të harxhohet 99%. Për festat e fundvitit, me Enologjinë e kemi një panair dhe shpresojmë që do të jetë i mirë. Gjithashtu do të ketë edhe koncert me disa këngëtarë vendorë, të cilët të t'i japin shije festave të fundvitit. Raporti janar-dhjetor 2024 është transparent. Ne do t'i shohim rezultatet në punë tona, nga vlerësimet e radhës që do t'i kemi nga GAP-it, KDI dhe MAPL. Të gjithë e dini që sivjet kemi shpëtuar nga thesari për shkak të kontratës kolektive, sepse urdhërat përmbartimorë janë bartur në tre mujin e vitit të ardhshëm. Shpresojmë që, Ministria e Financave nuk do t'i merr në kategoritë ekonomike, në investime, mallra dhe shërbime dhe subvencione, por i merr në paga dhe mëditje. Nga tani jam i bindur që ne jemi përsëri fitues të Grantit të Performancës, sepse pritet që raporti i ZKA-së të jetë i pakualifikuar. Sivjet do ta fitojmë grantin, për vitin e kaluar e kemi humbur për shkak të kontratës kolektive.



#### **4. Shqyrtimi dhe miratimi i planit të punës së kuvendit komunal për vitin 2025:**

**Skender Hamza:** Faleminderit kryesues! I nderuar kryetar, nënkryetar, kuvendarë, të pranishëm. Projekt-plani i punës së kuvendit të komunës është dokument i mbështetur në Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale, Statutin e Komunës, Rrgulloren e Punës së Kuvendit dhe në aktet tjera nënligjore. Me këtë plan synojmë t'i arrijmë objektivat për vitin 2025. Janë planifikuar t'i mbajmë 12 mbledhje të rregullta, 6 mbledhje në pjesën e parë të vitit dhe 6 në gjashtë mujorin e dytë. Sipas nevojës mund të mbahen edhe mbledhje tjera, përfshirë edhe seanca të jashtëzakonshme dhe solemne. Ne si sekretari e kuvendit, në bashkëpunim me kryesuesin dhe kryetarin e komunës, e kemi bërë këtë projekt-plan për vitin 2025. Më datë 10 dhjetor 2024 e kemi organizuar një punëtori, ku prezentë kanë qenë, anëtarët e KPF-së, ekzekutivi dhe kryesuesi i Komitetit për Komunitete. Aty kanë dalur disa propozime, vërejtje dhe sugjerime, të cilat i kemi përfshirë këtu. Me aprovimin e këtij plani, anëtarët e kuvendit do të kenë një pasqyrë për punët dhe aktivitetet e parapara për vitin 2025.

**Sejfullah Sejfullahu:** Dëshiroj të di, nëse plani i kuvendit për vitin e kaluar a është përmbyllur ashtu siç duhet? E kemi pasur një vizitë studimore që po e përmendi disa herë, thua që nuk kam dalur asnjëherë jashtë Krushës. Shihet që është e nevojshme që kuvendi ka nevojë për një vizitë studimore. Nëse është deri te buxheti, ne ju ndihmojmë pak.

**Nënkryetari:** Këtu pajtohem plotësisht!

**Kryesuesi:** I nderuar, Sejfullah Sejfullahu, vizita studimore do të bëhet në muajin gusht 2025. Nëse nuk kemi diskutime të tjera, e vendosim në votim. Kush është "për"?... Kundër?... Abstenim?... Me 18 vota pro, 1 kundër dhe asnjë abstenim votohet pika e katërt.

#### **5. Shqyrtimi dhe miratimi i planit të punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB), për vitin 2025:**

**Skender Hamza:** Përshëndetje edhe një herë! Projekt-plani i punës së KKSB-së është i mbështetur në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Ligjin Administrativ 27/2012 të Ministrisë të Punëve të Brendshme dhe Udhëzimit Administrativ 03/2012 të MAPL-së. Në këtë plan janë të planifikuar të mbahen 6 mbledhje, 3 në pjesën e parë të vitit dhe 3 mbledhje në pjesën e dytë të vitit 2025. Sipas nevojës, kryetari i komunës mund të mbajë edhe mbledhje të jashtëzakonshme dhe urgjente. Si koordinator i KKSB-së, bashkë me kryetarin e komunës, i cili është kryesues i KKSB-së, e kemi bërë një projekt-plan të punës për vitin 2025. Në mbledhjen e mbajtur të KKSB-së më 09.12.2024, ky projekt-plan është aprovuar dhe tani si procedurë kërkohet që të aprovohet edhe në kuvend. Për çdo propozim, ne si sekretari jemi këtu për ta përfshirë në plan.

**Kryesuesi:** Faleminderit Skender! Nëse nuk kemi diskutime të tjera, e vendosim në votim. Kush është "për"?... Kundër?... Abstenim?... Atëherë, me shumicë votash (16), votohet pika e pestë e rendit të ditës.

#### **6. Shqyrtimi dhe miratimi i planit të punës së Këshillit të fshatit Hoçë e Madhe për vitin 2025:**

**Senad Mullaavda:** Faleminderit kryesues! Të nderuar kuvendarë, kryetar, nënkryetar, ekzekutiv. Para vetes e keni projekt-planin e punës të këshillit të fshatit Hoçë e Madhe, që është formuar nga kuvendi. Në këtë plan parashihen mbledhjet që do të mbahen gjatë vitit 2025. Nëse keni ndonjë propozim, jeni të mirëseardhur dhe mund t'i dërgoni në sekretari të kuvendit.

**Defrim Kafexhiu:** E kam një kërkesë për kryetarin e komunës. Nëse ka arritur t'i bëjë zgjidhje koordinimit të këtij këshilli. Përderisa kam qenë unë kryesues, Senad i ka kryer këtë punë. Është mirë t'i krijohet një zgjidhje këtij pozicioni, si koordinues i këtij këshilli. Një kritikë tjetër e kam. A ka formë të penalizimi, që sot anëtarët e këshillit të fshatit Hoçë e Madhe nuk vinë këtu në seancën e miratimit të këtij plani, sidomos këta të komunitetit shumicë?

**Kryetari:** Fatkeqësisht ka kompetenca të veçanta dhe buron nga Pakoja e Ahtisarit. Pozicionin tonë e dini të gjithë. Përndryshe, ata paguhen njëjtë sikurse ju dhe sipas ligjit e kanë për detyrë të raportojnë dhe është mirë që të vijnë paktën këta të komunitetit shumicë. Sa për mua, është mirë që ky këshill mos të ekzistojë hiç, as si këshill as si ligj. Kushte kanë për punë dhe nuk besoj që i meritojnë ato paga.

**Kryesuesi:** Faleminderit kryetar! Atëherë, nëse dikush tjetër nuk ka ndonjë gjë rreth kësaj pike, e vendosim në votim. Kush është "për"?... Kundër?... Abstenim?... Me 14 vota "për", asnjë kundër dhe asnjë abstenim votohet pika e gjashtë.

#### **7. Shqyrtimi dhe miratimi i njoftimit për shkëputje të kontratës të lokalit afarist:**

**Erhan Morina:** Faleminderit kryesues! I nderuar kryetar, nënkryetar, kolegë drejtorë, të nderuar anëtarë kuvendit. Kryetari i komunës ju njofton me shkrim se do të shkëputet kontrata me numër 3319 e datës 01 shtator 2020. Lokali afarist ndodhet në rrugën “Avdullah Bugari” pa numër, me sipërfaqe 30m<sup>2</sup>, me arsyetimin e vetëm që pala nuk i është nënshtruar pagesave të rregullta, përkundër 8 vërejtjeve zyrtare me shkrim nga Drejtoria e Ekonomisë. Kur pala nuk i plotëson kushtet e parapara sipas kontratës, kryetari i komunës e gëzon të drejtën e ndërprerjes së kontratës njëanshëm. Të gjitha këto obligime janë përcjellur në procedurë përmbarimore, për inkasim të dhunshëm të mjeteve. Propozojmë që të shkëputet kjo kontratë dhe në procedura të tjera të jepet në shfrytëzim për një qytetar tjetër.

**Defrim Kafexhiu:** Faleminderit edhe një herë. Këtë shqetësim e kam ngritur edhe në KPF. Çmimi për qera është shumë më i ulët se sa është vlera e tregut të qerasë, në atë pjesën ku është ky aset i komunës. Besoj që personi tjetër që do ta marrë, qeraja do të jetë në përputhje me vlerën e tregut. Është një problem tjetër, kontrata është nënshkruar në vitin 2020 dhe tani jemi në fund të vitit 2024. Ky përveç disa pagesave që i paska kryer në vitin 2023, nuk paska bërë pagesa tjera. Besoj që Drejtoria e Ekonomisë, në bashkëpunim me institucionet tjera duhet ta trajtojë më mirë pronën publike.

**Kryesuesi:** Nëse nuk kemi diskutime të tjera, e vendosim në votim. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Me 13 vota “për”, asnjë kundër dhe 1 abstenim votohet pika e shtatë.

#### **8. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për dhënien e pëlqimit paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë, të pronës së paluajtshme të komunës, P- 02240-76, ZK- Rahovec:**

**Afrim Oruqi:** Faleminderit kryesues! Bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Ligjin për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës dhe Statutit të Komunës, kryetari i komunës ju propozon që të merrni vendim për dhënien në shfrytëzim një parcelë të komunës, e cila gjendet në zonën kadastrale të Rahovecit, në sipërfaqe 2 ha e 50 ari. Kjo parcelë gjendet te Maja e Shkodranit, qëllimi ka të bëjë me zhvillim të turizmit dhe rekreacionit. Afati kohor për dhënien e pronës së paluajtshme në shfrytëzim është 50 vjet. Kërkoj nga sekretariati që ta përmirësojë këtë lëshim teknik, në paragrafin e parë, jo për vendosjen e paneleve solare, por për ushtrim të veprimtarisë biznesore, turizëm dhe rekreacion. Çmimi fillestar do të caktohet në përputhje me rregulloret për taksa komunale në baza mujore.

**Kryesuesi:** Faleminderit drejtor! Nëse nuk kemi diskutime të tjera, e vendosim në votim. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Me 15 vota “për”, asnjë kundër dhe asnjë abstenim votohet pika e tetë.

#### **9. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim afatgjatë, të pronës së paluajtshme të komunës, P- 02240-76, ZK- Rahovec:**

**Afrim Oruqi:** Sipas ligjit, obligohemi të marrim vendim për formimin e komisionit. Komisioni përbëhet prej 5 anëtarëve që t’i zhvillojë procedurat në lidhje me pronën që u përmend më lart.

**Defrim Kafexhiu:** I kam dy pyetje për drejtorin për pikën paraprake, jo për këtë të komisionit. Personi që ka kërkuar që ta marrë këtë për shfrytëzim, a ka biznes, a është mërgimtar? Cili është qëllimi i dhënies në shfrytëzim dhe kohëzgjatja prej 50 viteve, a është kërkesë e tyre apo zemërgjerësi e juaja? Nëse nuk gaboj, e kemi pasur të njëjtën pronë në kuvend, sipas një kërkesë tjetër dhe në fund kur rregullorja e përcaktoi çmimin, vlera e qerasë dilke shumë e shtrenjtë. Tani, me çfarë procedure do ta rregulloni këtë çështje? Kërkoj mirëkuptim edhe 30 sekonda për një çështje tjetër. Në media lokale e kemi parë një projekt të paparë më herët në komunën e Rahovecit. Bëhet fjalë për një lagje moderne në zonën kadastrale në Rahovec. Investimi po bëhet komplet në pronën private dhe nuk ka ndonjë kërkesë që kërkohet nga komuna, qoftë infrastrukturën rrugore, ujësjellsin, apo energjinë elektrike. Vlera e investimit është rreth 10 milionë euro. Duke marrë parasysh këto gjëra dhe trajtimi që ekzekutivi po ia bënë pronave publike, ktyre pronave që po jepen në shfrytëzim dhe këtë pronë paraprake që u shkëput kontrata për shkak të trajtimit jo të duhur nga edhe ata që po e marrin me qera. Dua t’ju pyes, pse po i bëni telashe dikujt që po don t’i investojë 10 milion €. Ka bërë kërkesë në Drejtorinë e Urbanizmit dhe i është refuzuar kërkesa. Pse? Pasi është refuzuar kërkesa, investitori ka bërë kërkesë në Ministrinë e Planifikimit Hapësinor. Ministria e ka aprovuar ankesën e tyre dhe iu ka drejtuar Drejtorisë së Urbanizmit, ku ka thënë që sipas ligjit është në rregull dhe nëse nuk gaboj, duhet të vazhdoni dhe t’ia jepni kushtet ndërtimore. Tani, po vimë në një situatë tjetër, ku Drejtoria e Urbanizmit e refuzon përsëri, edhe me këtë shkresë të Ministrisë së Planifikimit Hapësinor. Unë nuk e di se ku është hezitimi juaj, që të ndodh ky investim 10 milionë euro në komunë të Rahovecit. Nëse diku është

problem me ligjin, atëherë duhet të bazohemi në vendimin e Ministrisë së Planifikimit Hapësinor dhe le ta mbajnë përgjegjësinë ata. Ku është problem? Sepse kështu penalizohet edhe zhvillimi i komunës dhe duke marrë parasysh që jemi prapa, ekzekutivi me këto veprime dëndencioze po e bllokton edhe më shumë zhvillimin e komunës së Rahovecit.

**Afrim Oruqi:** Në pyetjen e kuvendarit Defrim Kafexhiu: Bëhet fjalë për një prone e cila është në Rahovec, konkretisht përballë Majës së Shkodranit, në sipërfaqe prej 2 ha e 50 ari. Nuk është e njëjta parcelë që ka qenë në proces të ankandit publik. Ajo parcelë i ka 2 ha e 50 ari e 99m<sup>2</sup>. Sa i përket kërkesave, sipas ligjit ne nuk përcaktojmë a është biznes a është person fizik, apo juridik. Të gjithë kanë të drejtë t'i nënshtrohen kësaj kërkesë, përmes ankandit publik. A është mërgimtar, a është qytetar? Për neve të gjithë janë njëjtë. Janë qytetarë të Republikës së Kosovës. Nuk punojmë sipas zemërgjerësisë, këto çmime janë të përcaktuara me rregullore për taksa dhe tarifa. Te afatgjatësia, këtu kemi menduar kështu, sepse dy herë ka dështuar procesi i ankandit publik me një parcelë tjetër afër kësaj. Për shkak të çmimit edhe viteve, askush nuk është i gatshëm t'i investojë 1 milion € për 15 vjet. Ideja ka qenë e jona që t'i rrisim vitet dhe t'i ftojme njerëzit, duke iu treguar që prona është për 50 vjet. Përveç kësaj, ne vendim kemi propozuar edhe grejs-periodhë.

**Albnor Mullabazi:** Faleminderit kryesues! I nderuar kryetar, nënkryetar, drejtorë, asambleistë, pjesëmarrës në këtë seancë. Drejtoria për Urbanizëm-Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, punon në bazë të planeve të cilat janë aprovuar këtu në kuvend. Kërkesën që e kemi pranuar prej Hamdi Cenës për ndërtimin e lagjes, në pjesën që përkatësisht është trafa. Me PZhK kanë qenë të përfshiera veç dy parcela dhe në atë pjesë ku është bërë kërkesa, para miratimit të Planit Zhvillimor kanë qenë 10 parcela. Në PZhK si zonë ndërtimore janë përfshirë dy parcela. Kërkesë prej palës në atë kohë, para miratimit të PZhK-së nuk kemi pasur. Dy parcela, në sipërfaqe 85 ari janë përfshirë në zonë ndërtimore. Pasi është dorëzuar plani në ministri dhe ka marrë pëlqim nga ministria, pala ka bërë bashkimin e parcelave në zyret e gjeodezisë dhe kadastrës. Këto parcela, sipas PZhK-së janë në zonë bujqësore dhe janë tokë e klasës së parë dhe klasës së dytë. Pala ka të drejtë të ndërtojë vetëm në ato 85 ari, sepse është zonë ndërtimore. Lënda ka shkuar në ministri. Ministria ka bërë rishqyrtim, pra, nuk e ka aprovuar, por e ka kthyer në rishqyrtim. Në rishqyrtim është trajtuar lënda dhe është kërkuar prej palës që në ato 85 ari ta bie projektin dhe ta vazhdojë ndërtimin. Pjesa tjetër është jashtë zonës ndërtimore dhe Drejtoria për Urbanizëm vepron në bazë të PZhK-së dhe nuk mund ta shkelim atë plan, i cili është miratuar këtu prej asambleistëve. Nëse ministria mund ta bëjë ndonjë vendim që ne t'ia japim kushtet ndërtimore dhe nëse ministria është e gatshme ta marrë përsipër, jo në rishqyrtim, por t'i lëshojë kushte ndërtimore, atëherë në rregull.

**Defrim Kafexhiu:** Te përgjigjet e drejtorit Afrim Oruqi: Pyetjen e bëra, sepse po e din edhe vlerën e investimit dhe besoj që ajo vlerë ka ardhur prej kërkesës së dikujt. Nuk besoj që është ditur vlera e investimit dhe që mund të aplikojë kushdo. Pyetjen e bëra, se ne që merremi me politikë i dëgjojmë disa "përhajra". Më ka ardhur interesant, sepse të paktën parcela ende nuk është në ankand. Për këtë arsye pyeta rreth procedurave të kësaj parcele. Mendova që ka qenë parcela e njëjtë, por tani po e shoh që është parcelë tjetër. Shpresoj që kushdo që e merre, investimin do ta përfundojë në formën e planifikimit të tij dhe në formën e nënshkrimit të kontratës me Komunën e Rahovecit. Investimi është i mirëseardhur, sikurse ky tjetri që drejtori dha përgjigje. Dua ta pys drejtorin, nëse ministria e ka kthyer në rishqyrtim një vendim të Drejtorisë së Urbanizmit, duhet ta kuptojmë që komuna e Rahovecit ka interes për investime të tilla. Nëse ndodh kështu, atëherë është penalizim i përfitimit të banorëve të komunës sonë. Në qoftëse ministria e ka kthyer në rishqyrtim një vendim, besoj që ju keni bazë të mjaftueshme ligjore që vendimi të rishqyrtohet dhe jo ta jepni edhe një herë vendimin e njëjtë. Rishqyrtimin ministria e ka kthyer me një farë baze dhe nëse bashkimi i parcelave ka qenë në periudhë të duhur, para miratimit të Planit Zhvillimor Komunal, besoj që kjo punë duhet të bëhet dhe drejtoria duhet të jetë shtytëse e këtyre investimeve. Ministria mund të merre vendim edhe për kushte ndërtimore, por kjo formë e largimit të përgjegjësisë prej drejtorisë, që të kalojë në një instancë tjetër është e gabueshme.

**Albnor Mullabazi:** Defrim, ministria lëndët i bjen në rishqyrtim. Ankesa e palës ka shkur direkt në ministri, pa e kaluar Drejtorinë e Urbanizmit. Për lëndë të tjera, drejtoria në moment që ka kundërshtim me kushtet e lëshuara, pala bën ankesë dhe përmes Drejtorisë së Urbanizmit lënda shkon në Ministri të Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Në këtë rast, nga ministria neve na ka ardhur vetëm vendimi për rishqyrtim. Ne e kemi bërë ankesën dhe ia kemi dërguar ministrit dhe zyrtarës ligjore, e cila e ka bërë vendimit. Jemi konsultuar edhe me departamentin që është për planifikim. Ata janë thonë që duhet të bazohemi në Plan Zhvillimor. Siç po e shihni, ngjyra e gjelbër komplet zonë bujqësore dhe është tokë

e klasës së parë. Ky është plani i aprovuar në ministri dhe këtu shihet qartë kufiri ndërtimor shihet shumë qartë. Bashkimi është bërë pasi e kemi dorëzuar lëndën në ministri për me marrë pëlqimin. Prej palës, deri në momentin që është miratuar PZhK-ja, nuk kemi pasur kërkesë në drejtori që prona të futet në zonë ndërtimore.

**Kryetari:** Së pari, besoj që jemi jashtë pikës së rendit të ditës. Tani është formimi i komisionit për dhënien në shfrytëzim të parcelës. Mendoj që duhet të kemi propozime konkrete nga përfaqësuesit e grupeve politike këtu. Mirë është kur ka hapësirë ligjore, të kontribuojmë në nxitjen e zhvillimit të turizmit. Nuk jemi prapa, sepse janë investuar mbi 70.000.000 për energji solare, veç me një parcelë. Nuk jemi prapa, sepse jemi nëshkrues edhe të një kontrate të re për energji solare, që edhe kjo është mbi 70 milionë €. Jemi duke e pritur një kontratë tjetër për prodhimin e energjisë me fluturake. E falënderoj kuvendit që shumë prona i ka dhënë në shfrytëzim, që direkt ndikojnë në zhvillimin ekonomik, të turizmit dhe gastronomisë. Sa i përket interesave, dikush dikë e ka shok, e ka mik, por më së paku ekzekutivi. Ne përfaqësojmë konceptualisht procedurën në bazë të ligjit. Planit Zhvillimor Komunal është kushtetutë për zhvillimin e komunës. Drejtori i shpjegoi shumë mirë, askush nuk mund të ndërtojë jashtë kufijve ndërtimorë. Nëse ministria e merrë përsipër, unë ia jap dorën. Vetëm ata mund ta bëjnë, sepse certifikimin në fund e ka Ministria e Planifikimit Hapësinor. Kuvendi merrë vendim në përputhje me PZhK-në dhe kur ka mundësi brenda Planit Zhvillimor, leja ndërtimore nuk vonohet hiç. Ka biznese të fuqishme në komunë të Rahovecit me të cilat krenohemi dhe ka biznese të reja që përditë po hapen. E lus kryesuesin që të qëndrojmë në pikën në të cilën jemi, pra jemi te komisioni, i cili përbëhet nga 5 anëtarë, 2 janë nga ekzekutivi dhe unë e propozoj Besmirë Bytyqi dhe Erhan Morinën. Vlorë, mirë se erdhe në seancë. Ngushëllime! E di që e keni të vështirë, por mbahuni të fortë dhe me kurajo.

**Kryesuesi:** Faleminderit kryetar! Atëherë vazhdojmë me formimin e komisionit, kanë mbetur 2 anëtarë nga kuvendi dhe një nga sektori joqeveritar. Nga ekzekutivi i komunës janë Besmirë Bytyqi dhe Erhan Morina.

**Drilon Mustafa:** AAK, propozojmë Feriz Thaqin.

**Edonë Kryeziu:** LDK, nuk kemi propozim.

**Leonard Morina:** LVV, propozojmë Defrim Kafexhiun.

**Sejfullah Sejfullahu:** PDK, nuk kemi propozim.

**Ilir Pallqa:** I PAVARUR, nuk kam propozim.

**Kryesuesi:** Faleminderit! Atëherë, nga ekzekutivi i komunës janë Besmirë Bytyqi dhe Erhan Morina dhe nga kuvendi i komunës, Feriz Thaqi dhe Defrim Kafexhiu. Komisionin e vendosim në votim. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Me 20 vota “për”, 2 kundër dhe asnjë abstenim, votohet përbërja e komisionit.

**10. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për dhënien e pëlqimit paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës, P- 00325-0, ZK - Hoçë e Madhe:**

**Afrim Oruqi:** Bëhet fjalë për një parcelë me nr. 325-0. Parcela është e komunës dhe ka sipërfaqe 1 ha, 28 ari e 37 m<sup>2</sup>. Parcela është në zonë kadastrale Hoçë e Madhe dhe është jashtë perimetrit të zonës së mbrojtur. Saktësisht është në anën e majt të rugës në drejtim të Therandës dhe sipas PZhK-së është prodhim tretësor me shërbime tregtare, me shumicë dhe pakicë. Afati i propozuar i dhënies në shfrytëzim për këtë pronë komunale është 15 vjet.

**Kryesuesi:** Faleminderit drejtor! Nëse nuk kemi diskutime të tjera, e vendosim në votim. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Me 18 vota “për”, asnjë kundër dhe asnjë abstenim votohet pika e dhjetë.

**11. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër, të pronës së paluajtshme të komunës, P- 00325-0, ZK – Hoçë e Madhe:**

**Kryesuesi:** Atëherë, vazhdojmë me propozimet!

**Drilon Mustafa:** AAK, propozojmë Doruntina Sopjanin.

**Edonë Kryeziu:** LDK, nuk kemi propozim.

**Melinda Iska:** PDK, propozojmë Sejfullah Sejfullahun.

**Leonard Morina:** LVV, nuk kemi propozim.

**Kryetari:** Nga ekzekutivi e propozoj, Besmirë Bytyqi dhe Erhan Morinën. Nga sektori joqeveritar, Ilir Pallqën! E pata për shaka, faleminderit!

**Kryesuesi: Atëherë, nga ekzekutivi janë** Besmirë Bytyqi dhe Erhan Morina. Nga kuvendi, Doruntina Sopjani dhe Sejfullah Sejfullahu. Propozimet i vendosim në votim. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Atëherë me 22 vota “për”, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, votohet pika e 11-të e rendit të ditës.

**12. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për lirim nga taksa komunale Post-Telekomin e Kosovës:**

**Përparim Krasniqi:** Faleminderit kryesues! Telekom i Kosovës e ka bërë një propozim për një marrëveshje për investime të kapllit optik në tërë territorin e komunës së Rahovecit. Me rregullore për taksa komunale dhe tarifa, Drejtoria e Shërbimeve Publike obligohet që të marrë taksë për telekomin, apo për çfarëdo operatori tjetër ekonomik. Telekom i Kosovës është pjesë e qeverisë, pra, është aset kombëtar. Kërkojnë nga ne që së paku të lirohen nga taksa, kjo është ideja që nëse pajtoheni, të marrim një vendim në kuvend që të telekomi të lirohet nga taksa e gërmimit.

**Bejtullah Deliu:** Në dokument qenka në rregull, por në prezantim të thuhet “post-telekomi” nuk bën, duhet ta dallojmë. Ndërsa drejtori e tha sakt, telekomi i Kosovës.

**Kryesuesi:** Faleminderit! Nëse nuk keni diçka tjetër, po e vendosim në votim. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Me 15 vota “për”, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, votohet pika e 12-të.

**13. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik parcela P-71510057-05537-2 në zonën kadastrale Rahovec:**

**Afrim Oruqi:** Bazuar në rekomandimet e MAPL-së, do të marrim vendim për shpallje me interes të përgjithshëm një pjesë të parcelës me nr. 5537-2. Është në zonë kadastrale në Rahovec, konkretisht në anën e majt të rrugës, Rahovec – Brestoc. Bëhet fjalë për 5.4m<sup>2</sup>. Qëllimi i këtij interesi të përgjithshëm është që në të ardhmen të marrim vendim për këmbim këtë parcelë, me një pjesë të parcelës që i takon komunës. Qëllimi ka të bëjë me zgjerimin e rrugës, Rahovec – Brestoc. Me këtë vendim, do të shfuqizohet vendimi me nr. 01 Nr 259/24, i datës 29.10.2024.

**Kryesuesi:** Faleminderit drejtor! Nëse nuk keni ndonjë pyetje, po e vendosim në votim. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Me 20 vota “për”, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, votohet pika e 13-të dhe e fundit për këtë seancë. Ju falënderoj për vëmendjen dhe ju dëshiroj fat dhe suksese. Urime festat e fundvitit.

**Kryetari:** Meqenëse jemi në fund të vitit, mund ta pijmë ndonjë kafe bashkërisht. Përndryshe, urime Viti i Ri. Shëndet dhe mbarësi për të gjithë.

Procesmbajtësi:



Albion Krasniqi



